

KONKURS

“ACT CHANGE - Adapting to Climate Change in Time”

Hyrje

“Forumi i qyteteve të Adriatikut dhe të Jonit”, me kontributin e Komunitetit Evropian (programi LIFE+) promovon konkursin ndërkombëtar, rezervuar studentevë të arsimit të mesëm për realizimin e një **CD rumi ose DVD-je** multimediale me temë:

Ndryshimet Klimatike

Perceptim dhe njohuri për fenomenin
Ndërgjeshmëri për pasojat dhe prespektiva
Propozime dhe strategji përshtatjeje

Konkursi synon të sensibilizojë opinionin publik në lidhje me ndryshimet klimatike si rrjedhojë e ndotjes dhe e shfrytëzimit pa kriter të burimeve të tokës, në mënyrë që çdo qytetar të ushtrojë presion në qeveritë e tyre respektive për ti shtyrë drejt ndërmarrjes së politikave të përshtashme për të përballur ndikimet serioze në natyrë dhe për të bërë korrigjime para se të jetë tepër vonë. Konkursi i drejtohet të gjitha institucioneve të arsimit të lartë të qyteteve partner të projektit, do me thënë, Bashkia e Bullasit (Spanjë) dhe Bashkitë anëtare të “Forumit të qyteteve të Adriatikut dhe të Jonit” të Italisë, Sllovenisë, Kroacisë, të Malit të Zi, të Bosnje-Hercegovinës, të Shqipërisë dhe të Greqisë.

Tema e konkursit

Përballë fenomeneve të provokuara nga ndryshimet klimatike – shpesh nga pasojat katastrofike që lidhen me mutacionin e regjimit të reshjeve, vazhdimësisë së periudhave të gjata të thatësisë, rritjes së temperaturave, për paqëndrueshmëritë hidrogjeologjike etj. - procesi i Përshtatjes sëbashku me strategjitë e Zbutjes të efekteve të prodhuara, përfaqësojnë dy tipologji me veprime të ndryshme dhe plotësuese që duhet të bëhen aktive për të përballur impaktet e provokuara në territorin dhe në strukturën urbane të qytetit.

Për të evituar impaktet shkatërruese dhe të vështira për t'u menaxhuar, mbi të gjitha, për të udhëhequr efektet e pashmangshme që tashmë janë bërë të përsëritura, bëhet e nevojshme të rritet rezistenca e sistemit natyral, siguria e popullsisë, ruajtja e sistemit ekonomik, social dhe produktiv të secilit komunitet ose më mirë, mundësia për të shtuar kapacitetin e përshtatjes së sistemit urban dhe antropologjik ndaj impakteve aktuale dhe të ardhshme të shkaktruara nga ndryshimet klimatike.

Në nivel lokal, menaxhimi i impakteve të ndryshimeve klimatike imponon gjithmonë e më shumë, përcaktimin e një qasje të integruar që të ketë parasysh ambientin human në kompleks, nga lëvizshmëria e struktura urbane, nga struktura shoqërore tek trashëgimia historike, kulturore dhe e peisazhit (mbrotja e biodiversitetit, reduktimi i rrezikut të shëmbjeve të tokës, rreshqitjeve dhe përmbytjeve, struktura e lumenjve dhe erozioni, konsumimi i tokës, mbrotja e ambienteve), në mënyrë që të sigurojë kontroll, monitorim, dhe mbi të gjitha parandalim.

Realizo një “CD Rum ose një DVD Multimedial”

Konkursi konsiston në realizimin e një “CD Rumi ose të një DVD-je Multimediale” (Power Point ose Video) me një kohezgjatje maksimale prej 5 minutash. “CD Rumi ose DVD-ja Multimediale” mund të prezantohet:

- nga klasa në tërësinë e saj;
- nga një grup studentësh që bëjnë pjesë në një klasë të njëjtë;
- nga një grup studentësh që janë pjesë e klasave të ndryshme të një instituti.

Secili grup mund të përdori koordinimin dhe bashkëpunimin e mësuesve. Theksohet rëndësia e punës në grup, punë e përbashkët, frut i një rruge thellimesh e analizash të tematikës së trajtuar.

Rregullorja

1. Ky konkurs i titulluar “**ACT CHANGE(NRYSHIMI) - Adapting to Climate Change in Time (Adaptimi ndaj nryshimit klimatik në kohë)**” konsiston në realizimin e një “CD Rumi ose një DVD-je Multimediale” mbi temën e përshkruar të hyrja.
2. Përfituesit e këtij konkursi janë grupet e studentëve, klasave ose shkollave të arsimit të mesëm të qyteteve që janë pjesë e projektit “ACT LIFE+” dhe të “Forumi i Qyteteve të Adriatikut dhe të Jonit” të vëndeve vijuese: Spanja (municipaliteti Bullas), Italia, Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi, Bosnja-Hercegovina, Shqipëria dhe Greqia. Theksohet që në diversitetin e sistemit edukativ, pjesëmarrja në konkurs i rezervohet studentëve të moshës ndërmjet 14 dhe 18 vjeç.
3. Karakteristika teknike të “CD Rom ose DVD Multimedial”
Formati video lejohet
Formatet e lejuara janë: AVI, QUICK TIME, MPEG 1, 2 ose 4, Power Point.
Kohezgjatja e videos
Nga 60 sekonda deri në 300 sekonda.
4. Secili “CD Rum ose DVD Multimedial” duhet të jetë i pajisur me një përshkrim të shkurtër (maksimumi 20 rreshta) në gjuhën përkatëse ose anglisht.
5. Pjesëmarrja është e lire.
6. Dokumentat duhet të jenë të shoqëruara nga:
 - emërtimi, adresa e plotë, telefon, faks, e-mail i shkollës;
 - listë e studentëve/studenteve autore të “CD Rumit o DVD-së Multimediale”, me datat e lindjes, klasën që frekuenton;
 - emër e mbiemër i mësuesve koordinatorë të punës dhe lëndëve relative të mësimin;
 - emër e mbiemër i Drejtorit të shkollës;
 - autorizim për përdorim të “CD Rumit ose DVD-së Multimediale” për projektin dhe për aktivitetet e ndryshme në fushën e programit “ACT Change” (autorizimi do të nënshkruhet nga mësuesi koordinator ose nga Drejtori i Shkollës).
7. Mënyrat e nisjes: cdo shkollë duhet të nisi dokumentat me postë, në adresën vijuese:
Comune di Ancona - Forum delle Città dell’Adriatico e dello Ionio, Progetto “ACT LIFE08 ENV/IT/000436”, Largo XXIV Maggio, 1 - 60100 ANCONA, ITALIA.
8. Dokumentat do të priten deri më **31 mars 2012**, besohet pulla postale.

9. Shkolla, me nisjen e veprës, garanton që është prodhim original i saj, dhe e lë të lirë Forumin e Qyteteve të Adriatikut dhe të Jonit nga cdo përgjegjësi në lidhje me palë të treta që, në cfarëdo cilësie, që mund të deklarojnë, në kuadër të përdorimeve të parashikuara.
10. Një komision prej nr. 3 ekspertësh të emëruar nga Forumi i Qyteteve të Adriatikut dhe të Jonit (ndër të cilët një ekspert komunikimi, një mësues, një ekspert tematike ambientale) do të zgjedhë fituesin. Komisioni do të ahqyrtojë në përputhshmërinë e projektit në përputhje me kushtet e konkursit dhe, me vendim final do të përcaktojë (Cd Rumin ose DVD-në Multimediale” fituese, duke përcaktuar edhe dy projekte të tjera si të merituar për çmimin e dytë dhe të tretë.
11. Komisioni do të vijojë me vlerësimin e punëve duke shprehur vlera nga 1 deri në 5, duke patur parasysh parametrat vijuese:
 - ideim dhe kreativitet
 - kapacitetet komunikues
 - kolegialitet dhe përfshirje e shumë studentëve
 - koherencë shkencore.
12. I gjithë materiali i prodhuar dhe i nisur nga shkollat mund të paraqitet nëpër site apo të prezantohet në ndonjë ekspozitë ose të publikohet.
13. Projekti i shpallur fitues do të jetë pronë ekskluzive e “Forumit të Qyteteve të Adriatikut dhe Jonit” që i merr të gjitha të drejtat e përdorimit dhe të riprodhimit, rregjistrimit, depozitimit, publikimit, pa limit hapësire dhe kohe, me cdo mjet riprodhimi, edhe nese sot nuk njihet, duke i hequr projektuesit cdo te drejte nga puna e tij krijuese përveç rezervimit të të drejtave morale të atribuara me ligj. Cdo modifikim që do shihet i nevojshëm për përdorim, nuk do të diskutohet me projektuesin.
14. Promotorët e Konkursit nuk marin përsipër anjë përgjegjësi në lidhje me projektet që i nisen kësaj të fundit. Pjesëmarrja në konkurs implikon pranimin e pakushtëzuar të të gjitha normativave të këtij konkursi, gjithashtu të të gjithave normativave e ligjeve në fuqi.

Cmimet

- ✓ 1° i klasifikuar (fitues): furnizim me prodhime informatike (hardware e software) me një vlerë ekuivalente prej 5.000 euro;
- ✓ 2° i klasifikuar: furnizim me libra mbi tematikën e konkursit me një vlerë ekuivalente prej 300 euro;
- ✓ 3° i klasifikuar: furnizim me libra mbi tematikën e konkursit me një vlerë ekuivalente prej 150 euro.

“CD Rumi ose DVD-ja Multimediale” fituese do të projektohet gjatë seancës së mbylljes së projektit ACT LIFE+.

Për infomacione të mëtejshme:

Segreteria del Forum delle Città dell’Adriatico e dello Ionio
c/o Comune di Ancona – Assessorato Relazioni Internazionali
Piazza XXIV Maggio, 1 – 60123 Ancona (I)
Marina Krajina: marina.krajina@comune.ancona.it
Tel. +39 071 222 2385 – Fax: +39 071 222 2455